



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport

Nr. 7-155/01

Data: 17.08.2020

Duke u bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032 si dhe në Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013, Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, si dhe në pajtim me udhëzimet dhe procedurat dhe standardet e përgjithshme të shpallura nga MASH-t dhe Vendimi për kushtet, kriteret dhe afatet e regjistrimit të nxënësve në klasën e 10-të, për vitin shkollor 2020/2021 numër 01/3-70, datë 07.08.2020 Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport shpall:

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË GJIMNAZIT “KUVENDI I JUNIKUT” NË JUNIK PËR VITIN SHKOLLOR 2020/2021:

I. Gjimnazi “ Kuvendi i Junikut “ në Junik

Drejtimet :	Nr. I paraleleve	Nr. I nxënësve në Paralele	Gjithsejtë
1. Shkencat Natyrore	2	25	50
2. Shkencat Shoqërore-Gjuhësore	2	25	50
3. Hotelieri Turizëm	1	25	25
Gjithsejtë:	6		125

Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazit “Kuvendi i Junikut” për vitin shkollor 2020/2021, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9^e të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të, në gjimnazin “Kuvendi i Junikut” në Junik, duhet të paraqesin këto dokumente:

Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)

Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe

Certifikatën e lindjes ose Ekstraktin e lindjes.

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaz për vitin shkollor 2020/2021, behët më datën 17-21 gusht 2020, në lokalet e gjimnazit “Kuvendi i Junikut”, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në gjimnazin “Kuvendi i Junikut” në Junik me datën 28.08.2020.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

1. Suksesi nga shkollimi i obliguar (60%) 60 pikë
2. Suksesi nga lëndët prioritare në test (40%) 40 pikë
3. Kriteri i lëndëve nga suksesi për gjimnazi dhe shkolla të mesme të mjekësisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë 4 e më lartë (Së pari gjendet mesatarja e 4 lëndëve prioritet veç e veç, pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve).

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë **100** pikë.

3. Lëndët prioritare për drejtimet përkatëse

- **Drejtimi i shkencave natyrore:**
 - Lënda I- Fizikë,
 - Lënda II- Kimi,
 - Lënda III- Biologji,
 - Lënda IV- Matematikë.
- **Drejtimi shoqëror dhe gjuhësor:**
 - Lënda I- Gjuhë amtare,
 - Lënda II- Gjuhë angleze,
 - Lënda III- Histori,
 - Lënda IV- Gjeografi.
- **Drejtimi Hotelieri dhe Turizëm:**
 - Lënda I- Gjuhë amtare,
 - Lënda II- Gjuhë angleze,
 - Lënda III- Histori,
 - Lënda IV- Gjeografi.

Afati i Ankesave

Kandidati/jā i/e refuzuar dhe i/e cili/a dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit kanë të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqesin ankesë drejtorisë së shkollës.

Vërejtje : mosparaqitja e ankesës në afatin zyrtar, në shkollën përkatëse, nënkupton humbjen e të drejtës për ankesë në shkollën e dytë në Drejtorinë për AKRS, apo në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, DAKRS dhe MASH-t nuk i shqyrtojnë asnjë ankesë nëse ajo nuk është shqyrtuar nga Komisioni përkatës i shkollës.

Drejtori për AKRS

Fatos Shala

